

# KODI I ETIKËS SË GAZETARIT

# Kodi i Etikës së Gazetarit



*Tiranë, 2025*

*Botues:*



Rr. Gjin Bue Shpata, No.8, Tiranë, Albania

*Tel./fax:* ++ 355 4 2229800

*E-mail:* info@institutemedia.org

www.institutemedia.org

Kodi i Etikës së Gazetarit u hartua nga një grup ekspertesh  
i përbërë nga:

**Lutfi Dervishi**, gazetar

**Mark Marku**, shef i Katedrës së Gazetarise, Universiteti i Tiranës

**Remzi Lani**, drejtor i Institutit Shqiptar të Medias.

Konsulent ndërkombetar:

**Aidan White**, ish-Drejtor, Iniciativa per Gazetari Etike

*Hartimi i Kodit të Etikës së Gazetarit u bë i mundur  
me mbështetjen e një projekti të perbashket të  
International Freedom of Expression Exchange (IFEX)*

**ifex**

## **Hyrje**

Kodi i Etikës është një instrument vetërregullues që synon të përmirësojë cilësinë e gazetarisë dhe të inkurajojë ndjenjën e përgjegjësisë të gazetarëve në Shqipëri.

Parimet e këtij Kodi janë në përputhje me vlerat etike universale të gazetarisë, të njohura dhe të pranuarra gjerësisht nga mediat dhe organizatat e gazetarëve në vendet demokratike. Këto parime respektojnë po ashtu frymën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

## **Roli i Medias në Shoqëri**

Liria e fjalës, liria e informimit dhe e kritikës, liria e shtypit, si dhe aksesit në dokumentet zyrtare përbëjnë elementët bazë të një shoqërie demokratike.

Mediat luajnë një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në shoqëri, duke ofruar lajme e informacione të besueshme, në forma të ndryshme dhe nëpërmjet platformash të larmishme. Mediat shërbejnë si “watch dog” duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme autoritetet qeveritare si dhe organizatat, institucionet dhe bizneset. Mediat luajnë një rol themelor në proceset demokratike. Ato ofrojnë hapësira të gjera e një mjedis të sigurt që i lejon gazetarët të përmbushin detyrat e tyre në mënyrë të pavarur.

Mediat njohin rëndësinë e pluralizmit në shoqëri dhe respektojnë diversitetin e mendimeve, duke kundërshtuar çdo diskriminim mbi bazë gjinie, race, kombësie, gjuhe,

ideologjie, kulture, klase apo bindjeje, ose për çdo shkak tjetër.

Media njih dhe mbron si të drejtat, ashtu edhe detyrat e saj kundrejt publikut, duke ruajtur vazhdimisht balancën mes tyre.

## **Shtrirja e Kodit**

Rregullat e mëposhtme në lidhje me sjelljen aplikohen ndaj të gjithë personave të angazhuar në aktivitetet gazetaresk dhe botues.

Media, referuar këtij Kodi, përfshin të gjitha format e komunikimit që synojnë të informojnë, edukojnë ose ndikojnë publikun, pavarësisht nga formati apo teknologjia e përdorur. Kjo përfshin mediat tradicionale si shtypi, radioja dhe televizioni, si dhe platformat digjitale, botimet online, podcastet, blogjet, kanalet e videove dhe llogaritë në rrjetet sociale që angazhohen në veprimtari gazetareske.

Në kontekstin e teknologjive në zhvillim, media përfshin gjithashtu përmbajtje të krijuar ose të kuruar pjesërisht ose plotësisht përmes sistemeve të Inteligjencës Artificiale (IA), për aq kohë sa kjo përmbajtje shpërndahet publikisht dhe ndikon në ndërgjegjësimin dhe debatin publik.

Kodi i Etikës e merr si të mirëqenë faktin që të gjithë operatorët e medias dhe gazetarët njohin dhe pranojnë parimet vullnetare të përcaktuara në këtë Kod.

Të gjithë ata që angazhohen në gazetari ftohen të njohin dhe pranojnë parimet e mëposhtme si të domosdoshme për ushtrimin e gazetarisë në Shqipëri.

Gazetarët që shkelin parimet e këtij Kodi nuk duhet të presin mbështetjen dhe solidaritetin e kolegëve të tyre, organizatave mediatike apo sindikatave të gazetarëve.

## **1. Saktësia dhe Ndershmëria e Informacionit**

Gazetarët kanë të drejtën të kërkojnë informacion, të botojnë dhe të kritikojnë. Informacioni duhet të jete i vërtetë, i balancuar dhe i verifikuar.

### ***Saktësia***

Gazetari duhet të verifikojë informacionin përpara botimit me qëllim që të sigurohet që është i saktë, i bazuar në fakte dhe i besueshëm. Të gjitha të dhënat dhe informacionet i duhen nënshtruar shqyrtimit të kujdesshëm: qoftë kur është përfutur nga burime njerëzore, qoftë nga dokumentet.

Gazetarët duhet të bëjnë gjithmonë të qarta rastet kur informacioni nuk është i verifikuar dhe i konfirmuar.

Media nuk duhet të çorientojë publikun. Media duhet të bëjë të qarta rastet kur janë përdorur tekste, dokumente, imazhe dhe tinguj të manipuluar. Në mënyrë të veçantë, ato duhet të identifikojnë çdo material të gjeneruar apo të modifikuar nga sistemet elektronike të Inteligjencës Artificiale.

Media nuk duhet të botojë asnjë foto, imazh, material audio apo vizual të përpunuar që shtrembëron idetë apo faktet e burimit, me përjashtim të karikaturave, kartonëve apo pjesëve komike.

## ***Gazetaria e Paanshme***

Gazetarët duhet të bëjnë çmos për të ofruar raportim të paanshëm dhe të balancuar.

Një shkrim është i paanshëm dhe i balancuar kur gazetari u referohet të gjitha burimeve që mund të japin informacion të dobishëm ose të gjitha palëve të interesuara, por duke shmangur balancat e rreme.

Gjatë raportimit të një teme të debatueshme, gazetarët duhet të jenë përfshirës dhe të sigurohen që të gjitha palët e interesuara të kenë mundësinë për të sqaruar pozicionin e tyre.

Palët e kritikuar duhet të kenë të drejtën t'u përgjigjen akuzave, mundësisht në të njëjtin organ. Gjithsesi, dëgjimi i të dy palëve nuk e "çliron" gazetarin nga detyrimi për të paraqitur anët e tjera të çështjes dhe për raportuar në mënyrë sa më të vërtetë që të jetë e mundur për një temë ose një çështje.

Parimi i "paraqitjes së të gjitha palëve" mund të mos jetë i aplikueshëm në botime që përfaqësojnë opinione personale (editoriale, komente) si dhe raportime të një natyre faktike, të tilla si raportimi mbi takimet apo ngjarjet publike.

## ***Dezinformimi***

Gazetarët duhet të shmangin dezinformimin duke pënguar dhe eliminuar informacionin e rremë që është krijuar me qëllimin që të shkaktojë dëm.

Njëherësh, media dhe gazetaret duhet të shmangin përdorimin e përmbajtjes çorientuese të krijuar ose të shpërndarë pa një qëllim koshient për të shkaktuar dëm.

Në mënyrë të veçantë, gazetarët e lajmeve duhet të jenë të vëmendshëm ndaj rrezikut që paraqesin lajmet e rreme (fake news) online, që zakonisht nënkuptojnë një përmbajtje digjitale të rreme, që mund të jetë një formë e dezinformimit ose çinformimit, në varësi të burimit.

## **2. Dallimi i Faktit nga Opinioni**

Media duhet të bëjë qartë dallimin midis opinionëve dhe fakteve. Opinionistët, karikaturistët dhe kritikët janë të lirë të shprehin opinionet e tyre për ngjarje dhe persona.

Lajmi lidhet me informacionin e mbështetur në evidencë, fakte dhe të dhëna, ndërsa opinioni përmban dhe shpreh ide, gjykime dhe vlerësime të gazetarëve, redaktorëve dhe botuesve.

## **3. Korrektimi dhe Replika**

Media duhet të jetë e hapur për t'u angazhuar me audiencën dhe për t'u marrë me komentet dhe ankesat legjitime.

Media duhet të publikojë një korrigjim të qartë dhe përshtatshëm kur demonstron se ka botuar një informacion të pasaktë dhe të shtrembëruar. Media duhet të kërkojë ndjesë kur është e nevojshme.

Pala e kritikuar gjithmonë duhet të ketë të drejtën për t'u përgjigjur.

Nëse replika nuk është e përshtatshme për botim në formën që ka, ndryshimet duhet të diskutohen me autorin. Nëse ai/ ajo nuk mund të kontaktohet brenda një kohe të arsyeshme, përgjigja mund të publikohet në formë të ndryshuar. Megjithatë, asnjëherë nuk duhet ndryshuar thelbi i saj.

#### **4. Marrëdhëniet me Burimet**

Gazetarët duhet të bëjnë çdo përpjekje për të mbledhur informacion nga të gjitha burimet e mundshme me qëllim që të ofrojnë informacion të saktë, të plotë dhe të paanshëm.

Informacioni duhet të mblidhet në forma etike dhe të ligjshme. Gazetarët duhet të jenë transparentë në punën e tyre. Rrengjet nuk janë të pranueshme, përveçse nëse bëhen për arsye sigurie dhe duhet të bëhen të njohura më vonë, në një kohë të përshtatshme.

Një person që intervistohet ka të drejtë të dijë në cilën media dhe në çfarë konteksti do të përdoren prononcimet e tij.

Media duhet të ushtrojë kujdes të posaçëm kur merret me burime që janë anëtarë të grupeve vulnerabel, të tillë si fëmijë dhe të rinj, viktimë të dhunës apo pakica.

Gazetarët duhet të shmangin mundësinë që të përdoren për interesa personale të të tretëve, duke bërë kujdes në përzgjedhjen e burimeve dhe duke u siguruar që informacioni që marrin është korrekt.

Media duhet të mos shtrembërojë dhe as keqpërdorë pohime të bëra në një kontekst specifik. Veçanërisht, kujdes i duhet kushtuar personave nga të cilët nuk pritët të jenë të ndërgjegjshëm për efektin që mund të kenë pohimet e tyre.

Gazetarët nuk duhet të bëjnë publik emrin e një personi që ka dhënë informacion mbi baza konfidenciale, veç rasteve kur personi në fjalë ka dhënë pëlqimin shprehimisht.

E drejta e anonimitetit mund të shkelet vetëm:

- a) Nëse ka dyshime se burimi ka shtrembëruar në mënyrë të ndërgjegjshme të vërtetën dhe ka vepruar në keqbesim të qëllimshëm;

- b) Nëse referenca ndaj emrit të burimit është e vetmja mënyrë për të shmangur një dëm të rëndë dhe të pashmangshëm ndaj të tjerëve;
- c) Nëse informacioni përkatës lidhet me planifikimin e një akti të rëndë kriminal.

Nëse gazetarit i mohohet padrejtësisht aksesin në informacionin e kërkuar, ai/ajo ka të drejtën të informojë publikun për këtë.

## **5. Pavarësia editoriale**

Media duhet të shmangë konfliktet e papranueshme të interesit dhe duhet të mos lejojë kurrfarë influence që buron nga bindjet personale, nxitjet politike ose financiare për të ndikuar në raportimin e saktë dhe të paanshëm të gazetarëve dhe në punën e redaksive.

Gazetarët, botuesit dhe pronarët e mediave duhet t'u rezistojnë kërcënimeve, provokimeve apo nxitjeve për të ndikuar, shtrembëruar apo fshehur informacion. Ata nuk duhet të përdorin asnjë informacion apo të dhënë të mbledhur gjatë punës së tyre për përfitim personal.

Përmbajtja editoriale duhet të dallohet qartë nga marketingu, reklama, materialet e përgatitura nga parti apo institucione/organizata të tjera, apo nga përmbajtja e sponsorizuar. Përmbajtja e sponsorizuar duhet të tregojë qartë identitetin e sponsorit.

Reklamat komerciale dhe politike, si dhe përmbajtja e sponsorizuar – përfshi artikuj dhe suplemente – duhen etiketuar qartësisht për t'u siguruar që audienca e medias t'i dallojë nga përmbajtja editoriale e publikimit.

## **6. Marrëveshja para Publikimit**

Gazetarët që bien dakord të mos botojnë një informacion apo material për një periudhë të caktuar duhet ta respektojnë këtë marrëveshje. Një marrëveshje e tillë (embargo) duhet të konsiderohet e pavlefshme nëse informacioni publikohet nga një palë tjetër ose kur personi që ka kërkuar embargo i shkel në ndonjë mënyrë kushtet e marrëveshjes së arritur midis palëve.

Në interes të të qenit të drejtë dhe të saktë, gazetarët mund t'ua tregojnë artikujt e tyre të lajmeve palëve të interesuara përpara publikimit, por nuk duhet të japin veton mbi të drejtën për të publikuar dhe duhet të jenë të lirë të vendosin vetë se cilat sugjerime mund të marrin në konsideratë.

## **7. Përgjegjësia pas Publikimit**

Stafi editorial është përgjegjës për botimin e lajmeve dhe artikujve, ashtu edhe të letrave për redaktorin, komenteve apo përgjigjeve në faqen e internetit të medias, përfshi rastet ku emri i autorit është hequr apo është nënshkruar me një pseudonim.

Stafi editorial duhet të publikojë, në të mirë të publikut, termat dhe kushtet për përzgjedhjen dhe publikimin e komenteve nga publiku. Media duhet t'i monitorojë dhe shqyrtojë këto komente dhe të ndër marrë hapa për t'u siguruar që termat dhe kushtet e publikimit respektohen.

Stafi editorial ka të drejtën të shtojë një "shënim" tek komentet dhe përgjigjet, apo edhe të vendosë të mos i publikojnë ato fare, me përjashtim të rasteve kur ka premtuar më parë ta bëjë një gjë të tillë. Redaksia rezervon të drejtën të redaktojë apo shkurtojë letrat për redaktorin, apo komentet, me kusht

që redaktimi të mos ndryshojë kuptimin e tyre. Nëse organi mediatik do të vendoste të publikonte një letër për redaktorin apo një koment, duhet ta bëjë këtë brenda një periudhe kohe të arsyeshme nga paraqitja e tyre për botim tek botimi i saj.

Përpara publikimit të një komenti, apo një letre për redaktorin, që përmban akuza të rënda kundër një pale të tretë, redaksia apo redaktori duhet të investigojë nëse ka baza për këto akuza. Po ashtu, palës së akuzuar i duhet dhënë mundësia për t'u përgjigjur.

Nuk do të ishte realiste të pritet që të gjitha komentet të lexohen, redaktohen apo refuzohen përpara publikimit. Megjithatë, redaksia apo redaktorët mund të fshijnë apo heqin komente të papranueshme nga botimi kur ato janë abuzive, me gjuhë urrejtjeje, apo gjendet se përmbajnë pretendime keqdashëse dhe të pabazuara. Në rastet kur ka ankesë se një koment përmban akuza apo fyerje të rënda drejtuar ndaj një pale të tretë, redaksia dhe redaktorët duhet të investigojnë nëse ka ndonjë bazë për akuza të tilla dhe, nëse jo, komenti duhet hequr nga botimi.

## **8. Diversiteti**

Media duhet të mos botojë materiale që nxisin urrejtje apo dhunë ndaj individëve mbi bazën e racës, fesë, kombësisë, ngjyrës, origjinës etnike, anëtarësisë, gjinisë, orientimit seksual, statusit civil, paaftësisë, sëmundjes apo moshës ose mbi çdo shkak tjetër që çon në diskriminim.

Çdo botim duhet të mos specifikojë origjinën, etnicitetin, kombësinë, racën, fenë apo orientimin seksual të një grupi apo individi, përveç rasteve kur gjykohet e rëndësishme dhe e nevojshme për të kuptuar më mirë faktet dhe opinionet e paraqitura në publikim.

Redaksitë dhe gazetarët duhet të hartojnë udhëzime të brendshme dhe të përcaktojnë objektiva organizative për t'iu përmbajtur standardeve të diversitetit

Këto standarde duhet të reflektohen në udhëzimet editoriale që bazohen në parimet etike të raportimit inkluziv dhe që tregojnë ndjeshmëri ndaj rreziqeve të diskriminimit dhe të gjitha formave të stereotipizimit në portretizimin e minoriteteve, migrantëve, refugjatëve ose grupeve vulnerabël.

Redaksitë duhet të sigurojnë paanshmëri në mbledhjen e lajmeve dhe duhet t'u japin hapësirë opinioneve dhe pikëpamjeve të grupeve minoritare që janë subjekt i raportimit gazetaresk.

Gazetaret duhet të jenë të kujdesshëm dhe duhet të përpiqen të frenojnë anshmërinë në raportimin e tyre, personale, apo institucionale, duke treguar vëmendje të posaçme ndaj anshmërive potenciale të përdorimit të Inteligjencës Artificiale (IA) ose burimeve online të informacionit.

Redaksitë e lajmeve duhet të rishikojnë dhe aty ku është e nevojshme të marrin masa për të përmirësuar diversitetin brenda tyre, duke i dhënë prioritet diversitetit ndaj aspekteve të tjera komerciale.

## **9. Ndërhyrja në jetën private**

Media dhe gazetarët duhet të respektojnë nderin dhe reputacionin e individëve që bëhen objekte të interesit të tyre profesional.

Çdo informacion i pasaktë apo i rremë që dëmton, qëllimisht ose joqëllimisht, imazhin dhe reputacionin e një personi tjetër përbën cenim të dinjitetit njerëzor.

Gazetari duhet të respektojë të drejtën e individit për privatësi. Vetëm mbrojtja e interesit publik mund të justifikonte investigimet gazetareske që ndërhyjnë në aspektet private të jetëve të individëve. Gazetarët duhet t'u referohen aspekteve personale apo private të jetëve të personave vetëm kur ato janë relevante për lajmin.

Gazetarët duhet të përdorin metoda të ndershme për të mbledhur informacion. Ata përdorin rrengje, kamera të fshehta, mikrofona dhe pajisje të tjera të posaçme, ose fshehin identitetin e tyre profesional, vetëm në ato rrethana ku:

- a) Nuk ka mjete të tjera për të siguruar informacionin që kërkohet.
- b) Informacioni përbën shqetësim urgjent dhe serioz për publikun.

Gazetarët duhet të tregojnë kur metoda të tilla janë përdorur në shkrimin/programin e tyre ose të ofrojnë informacion për to kur e lejojnë rrethanat.

Përdorimi i kamerave në publik apo në institucione duhet të respektojë dëshirën dhe ndjeshmërinë e personave të pranishëm.

Figurat publike gëzojnë më pak të drejtë për privatësi se sa individët e tjerë. Megjithatë, informacioni për jetët e tyre private dhe informacioni që lidhet me familjet dhe të njohurit e tyre duhet bërë publik vetëm kur i shërben interesit publik. Zyrtarët publikë po ashtu justifikohen të mos bëjnë publike jetët e tyre private, përveç rasteve kur jeta e tyre private mund të ndikojë në veprimtarinë e tyre publike.

## **10. Konflikti i Interesit**

Gazetarët, redaktorët dhe botuesit nuk duhet të kërkojnë përfitim personal nga informacioni dhe të dhënat e grumbulluara nga organi i tyre mediatik. Organet mediatike duhet të sigurohen që të ketë marrëveshje të brendshme për deklarimin e konflikteve të mundshme të interesit në të gjitha nivelet e pronësisë, menaxhimit dhe veprimtarisë editoriale.

Pronarët, redaktorët e mediave dhe gazetarët nuk kanë të drejtën të përdorin informacionin profesional që grumbullojnë gjatë kryerjes së punës së tyre për ndonjë qëllim tjetër përveçse për të informuar publikun.

Gazetarët duhet të shmangin mbulimin e lajmeve ku kanë një interes personal të drejtpërdrejtë.

Gazetari duhet ta konsiderojë shkelje të rëndë të etikës profesionale pranimin e ryshfetit të çfarëdo lloj forme për të ndikuar në publikimin apo mospublikimin e një informacioni.

## **11. Nxitja e Krimet dhe Dhunës**

Propagandimi i luftës, dhunës, zemëratës apo informacionit keqdashës që synon të lëndojë ndjenjat e të gjithë publikut apo pjesëve të tij është joetik dhe i papranueshëm në çfarëdo produkti mediatik.

Dhuna dhe brutaliteti nuk duhen sensacionalizuar. Përdorimi i imazheve eksplicite të dhunës ose akteve çnjerëzore është i ndaluar. Raportimi duhet të marrë parasysh nevojën për të mbrojtur minorenët dhe grupet vulnerabël të shoqërisë.

Gazetarët dhe media duhet të mos glorifikojnë krimet dhe terrorizmin apo ndonjë veprimtari tjetër mizore apo çnjerëzore.

Media duhet të raportojë me kujdes dhe ndjeshmëri çështjet e krimit dhe dhunës dhe të trajtojë me maturi identifikimin e viktimave dhe dëshmitarëve të krimit. Në rastet kur ka të bëjë me sulme seksuale, media nuk duhet të identifikojë viktimat përveç rasteve kur japin pëlqimin me vullnetin e tyre.

## **12. Raportimi i aksidenteve dhe fatkeqësive**

Gazetarët duhet të respektojnë dinjitetin e viktimave dhe familjeve të tyre dhe duhet të lejojnë njerëzit të mbajnë zi privatisht duke i raportuar tema të tilla me simpati dhe vetëpërmbytje.

Në raste aksidentesh dhe fatkeqësish, media duhet të mbajë parasysh që operacionet e shpëtimit dhe ndihma për viktimat e personat në rrezik kanë përparësi kundrejt të drejtës së publikut për t'u informuar.

Media duhet të mos e teproje me botimin e fotove/pamjeve eksplicite të katastrofave, aksidenteve apo dhunës që mund të lëndojë ndjenjat e të afërmeve të të prekurve si dhe ndjeshmërinë e publikut.

Viktimat apo personat e zhdukur nuk duhen identifikuar nëse të afërmit e tyre nuk janë informuar më parë.

## **13. Raportimi i Procedurave Gjyqësore dhe Prezumimi i Pafajësisë**

Raportimi nga gjykata (përfshi publikimin dhe transmetimin e imazheve), duhet të jetë i saktë, i drejtë, joparagjykues, dhe që respekton plotësisht të drejtën për një gjykim të drejtë.

Gazetarët duhet të respektojnë gjithmonë prezumimin e pafajësisë. Mediat duhet të rezistojnë ta përshkruajnë dikë si kriminel përpara vendimit përfundimtar nga gjykata.

Gjatë raportimit të krimeve të minorenëve dhe procedurave të gjykatave të minorenëve, media duhet të ushtrojë vetëpërmbytje për hir të konsideratës për të ardhmen e të rinjve në fjalë. Ky rekomandim aplikohet gjithashtu në raportimin e viktimave të trafikut ilegal të njerëzve.

Media duhet të shqyrtojë me kujdes nëse është me vend të botojë fakte mbi skandalet familjare, apo të rikujtojë krimet e mëparshme të kryera nga individë që e kanë shlyer dënimin e tyre.

#### **14. Mbrojtja e Fëmijëve, Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Personave me Probleme të Shëndetit Mendor**

Gazetari duhet të respektojë të gjitha parimet e sanksionuara në Konventat Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve dhe legjislacionin shqiptar mbi të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, të personave me aftësi të kufizuara dhe të atyre me probleme të shëndetit mendor.

Gazetari duhet të mbrojë të drejtat dhe dinjitetin e fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara dhe me problem të shëndetit mendor, përfshirë të drejtën e tyre për t'u dëgjuar.

Si rregull i përgjithshëm, nuk ka kundërshtim për publikimin e fotove dhe emrave të personave të rinj të zhdukur, por këto duhet të publikohen vetëm me marrëveshjen e autoriteteve përkatëse dhe të rriturve përgjegjës.

Gazetarët nuk duhet të shfrytëzojnë pafajësinë dhe besimin e fëmijëve dhe mund të publikojnë informacion ose imazhe mbi jetën private të një fëmije vetëm nëse ka një interes publik mbizotërues.

Gazetarët normalisht nuk duhet të intervistojnë fëmijë nën 18 vjeç për çështje personale në mungesë të prindërve apo personave përgjegjës për ta.

## **15. Mbrojtja e të Dhënave dhe Siguria Kibernetike**

Gazetarët duhet të respektojnë standardet etike në trajtimin e informacionit digjital, duke siguruar mbrojtjen e privatësisë digjitale të burimeve dhe ruajtjen e të dhënave të ndjeshme.

Gazetarët duhet të përdorin kanale të sigurta komunikimi, të kodojnë të dhënat e ndjeshme kur është e nevojshme dhe të shmangin shpërndarjen e informacionit që mund të ekspozojë burimet ndaj dëmeve.

Keqpërdorimi kibernetik, që përfshin hakerimin, phishing dhe aksesin e paautorizuar të të dhënave, duhet të parandalohet në mënyrë aktive.

Gazetarët kanë për detyrë të verifikojnë vërtetësinë e përmbajtjes digjitale duke respektuar ligjet e privatësisë dhe konsideratat etike. Organizatat mediatike duhet të promovojnë ndërgjegjësimin për sigurinë kibernetike dhe të ofrojnë trajnime për gazetarët për të mbrojtur veten dhe burimet e tyre në mjedisin digjital.

## **16. Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale**

Gazetari duhet të respektojë të drejtat e autorit, dhe duhet të nxisë kolegët të respektojnë të drejtën e autorit të të tjerëve në çfarëdo fushe krijimtarie. Gazetarët duhet t'ia atribuojnë informacionin që përdorin burimit original. Plagjiatura është e papranueshme.

Media dhe gazetarët janë në shkelje të të drejtës së autorit nëse:

- a) Botojnë ose përpiqen të botojnë punën krijuese të të tjerëve (produktin intelektual) si të jetë e tyre (plagjiatura);

- b) Citojnë punën e të tjerëve në mënyrë të tillë që shtrembërojnë kuptimin fillestar të tekstit, duke botuar shtrembërimin si realitet, ose duke paraqitur me dashje një person tjetër si autor;
- c) Botojnë si të tyre një temë të konsideruar si origjinale – të hulumtuar dhe të publikuar nga dikush tjetër – pa iu referuar autorit origjinal;
- d) Dorëzojnë punën e tyre për publikim dy a më shumë botuesve në të njëjtën kohë – pa e bërë të ditur këtë fakt – apo dorëzojnë një punim të publikuar më parë pa ia bërë të ditur këtë fakt botuesit të dytë;
- e) Botojnë një punë pa pëlqimin e autorit, ose ndryshojnë materialin pa leje, ose e vendosin në rrethana të papërshtatshme (montim fotografish), apo në rrethana të ndryshme nga ç’është rënë dakord, pa pëlqimin e autorit.

## 17. Përdorimi i Inteligjencës Artificiale (IA)

Gazetarët dhe redaksitë e lajmeve mund të përdorin sistemet e IA në mbledhjen, krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve duke respektuar parimet e mëposhtme:

- a) **Transparenca:** bërja e ditur plotësisht se si është përdorur IA dhe identifikimi i përmbajtjes së botuar, e cila është gjeneruar duke përdorur IA;
- b) **Mbikëqyrja njerëzore:** vendimet për përdorimin nga redaksia të IA dhe për botimin e përmbajtjes editoriale të prodhuar nga IA duhet të merren nga gazetarët dhe redaktorët përgjegjës;

- c) **Masat mbrojtëse etike:** zhvillimi dhe përdorimi i IA nëpër redaksi duhet të sigurojë vazhdimësi në respektimin e etikës gazetareske dhe të standardeve profesionale;
- d) **Përgjegjësia:** IA duhet të jetë subjekt i monitorimit dhe shqyrtimit të vazhdueshëm. Përgjegjësia për përmbajtjen mbetet te personeli editorial përkatës.

## **18. Marrëdhëniet mes Gazetarëve**

Në marrëdhëniet e tyre të biznesit dhe të punës media dhe gazetarët duhet të njohin rëndësinë e konkurrencës së drejtë dhe solidaritetit profesional, si dhe të ruajnë balancën.

Gazetari/-ja nuk duhet të veprojnë me keqdashje ndaj kolegeve, t'i pengojë ata të grumbullojnë informacion, t'i çorientojë qëllimisht, apo të veprojnë në ndonjë mënyrë tjetër që cenon solidaritetin profesional.

As gazetarët individualisht, as redaksitë nuk duhet ta përdorin statusin dhe rolin e tyre si profesionistë të medias për rivalitete dhe mosmarrëveshje brenda komunitetit të gazetarëve.

Gazetarët duhet të respektojnë konfidencialitetin e çështjeve personale dhe sekretet profesionale të redaksisë kur kjo nuk përbën shkelje të ligjit dhe të Kodit të Etikës.

Media duhet të respektojë të drejtën e gazetarëve individualisht për të vepruar sipas ndërgjegjes së tyre dhe të drejtën e tyre për të refuzuar detyra që iu caktohen, apo për të mos u identifikuar si autor publikimesh, të cilat besojnë se janë në shkelje të gërmës dhe frymës së këtij Kodi.

## **19. Interesi Publik**

Termat e këtij Kodi ofrojnë udhëzime thelbësore dhe të nevojshme për ushtrimin e gazetarisë etike dhe mund të injorohen vetëm në rrethana të jashtëzakonshme me qëllim që t'i shërbejnë interesit publik.

Interesi publik përkufizohet në këto rrethana si më poshtë:

- Çështje që përbëjnë shqetësim urgjent dhe të menjëhershëm për shëndetin dhe sigurinë publike;
- Gjetja, parandalimi dhe të bërit publik i krimeve të rënda, korrupsionit, dhe abuzimeve të pushtetit;
- Parandalimi i qarkullimit të informacionit që mund të çorientojë seriozisht publikun.

Interesi publik legjitim nuk justifikon sensacionalizmin dhe në frymën e këtij Kodi, nuk duhet ngatërruar kurrë me informacionin që është “interesant për publikun.”

## **20. Gjuha Shqipe**

Gazetarët duhet të respektojnë dhe t'u përmbahen me kujdes rregullave të gjuhës shqipe. Përdorimi i fjalëve të huaja duhet shmangur, përveçse për qartësi kuptimi apo kur është i përshtatshëm në raportimin e drejtpërdrejtë.

